

# NZ GROUP SHPK –STATUTI

---

## **KREU I EMRI DHE FORMA E SHOQËRISË, SELIA, KOHËZGJATJA, OBJEKTI**

### **NËNI 1 EMRI DHE FORMA E SHOQËRISË**

- 1.1 Emri i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar është NZ GROUP SHPK (më poshtë e quajtur “Shoqëria”).
- 1.2 Shoqëria është e organizuar në formën e një shoqërie tregtare me përgjegjësi të kufizuar, në kuptim të Ligjit Nr. 9901 datë 14. 04. 2008 i ndryshuar “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”.
- 1.3 Në rast transferimi të veprimtarisë tregtare mund të ruhet i njëjti emërtim me kusht që personi juridik të shtojë në këtë emërtim një shënim i cili ka të bëjë me transferimin.

### **NËNI 2 SELIA**

- 2.1.1 Selia e Shoqërisë ndodhet në adresën: Rruga e Barrikadave, Apartamenti nr 7, Pallati Green Tarac, Kati 3, Numer Pasurie 6/764+1-Njesia bashkiake Nr.9, Tiranë
- 2.2 Asambleja e ortakeve mund të vendosë mbi transferimin e selisë së Shoqërisë në një adresë tjetër. Personat përgjegjës për administrimin e Shoqërisë mund të çelin ose mbyllin degë dhe/ose zyra përfaqësimi, si brenda ashtu edhe jashtë Republikës së Shqipërisë.

### **NËNI 3 KOHËZGJATJA**

- 3.1 Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj për një periudhe kohore me afat të pacaktuar duke filluar nga data e regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.

### **NËNI 4 OBJEKTI I SHOQËRISË**

- 4.1 Shoqëria ka për objekt të saj kryerjen dhe marrjen pjesë në të gjitha aktivitetët që një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar mund të ushtrojë në bazë të legjislacionit shqiptar, dhe në veçanti:

Veprimtari në fushën e mirëmbajtjes fizike, esketike dhe shëndetësore të trupit, Fitnessit, ushtrimeve dhe kërcimit, etj. Import eksport dhe tregtim i pajisjeve të ndryshme. Shitje- blerje pasuri të luajtshme e të paluajtshme dhe/ose pjesëmarrje në shoqeri të tjera tregtare. Ofrim shërbimesh si trajtim flokesh, larje, prerje, modelim. Tregtim i mallrave e produktëve të kozmetikës. Zhvillim i aktivitetit të berberit dhe kurse të formimit profesional në fushën e parukerisë dhe estetikës. Shërbime dhe trajtime estetike të llojeve të ndryshme etj. Të krijoje, blejë, financojë, investojë, të kryeje sipërmarrje dhe projektë, shërbime dhe asistënce të të gjitha llojeve përonave fizike dhe juridike, përfshi shërbimet menaxhuese, konsulence, planifikuese, keshilluese, financiare, investuese, teknike, administrative. Agjensi mjetë transporti të çdo lloji me qera, shitëbletje të mjetëve të ndryshme. Agjensi Turistike, paketa turistike dhe çdo shërbim tjetër që lidhet me këtë aktivitet. Shitje bileta avioni dhe transport tjetër të çdo lloji. Transport kombëtar dhe nderkombëtar në rrugë detare, tokësore, apo ajrore për vete dhe për të tjerë. Import-eksport dhe tregtimi me shumicë e pakicë brenda dhe jashtë vendit, për llogari të vetë shoqërisë, apo të tretëve të matërialeve të ndërtimit, produktëve ushqimorë dhe industrialë, makinërive, pajisjeve e pjesë kembimi të tyre, lëndëve të para, produktëve të gatshme e gjysëm të gatshme, mineralëve. Riparimin e makinërive të ndërtimit dhe mjetëve rrugore për nëvojat e shoqërisë dhe të të tretëve; aktiviteti ndërtimi, tregtar, financiar, konsulence, qiradhenës apo dorezanës, gomisterie. Dyqan Shitje produktë ushqimorë, ëmbelsira, paketime kafe, shërbim delivery, shërbim take-away, import-eksportit, përpunimit dhe tregtimit me shumicë dhe pakicë të kafesë dhe nënproduktëve të saj, bar kafe. Import-eksportit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë dhe pakicë të të gjitha mallrave industrialë, ushqimorë, bujqësorë dhe blegtoralë, të fushës së ndërtimit, imobiliarë, makinëri, pajisje dhe matëriale mjekësorë, për fushën e turizmit, të shëndetësisë, të arsimit dhe telekomunikacionit. Hapja, menaxhim baresh, restorantësh, hoteleri turizëm, fast food, diskotekash dhe lojra argëtuese për femijë, qendër sportive, qendër pushimi dhe kurative, agjensive turistike, të udhëtimit dhe të telekomunikacionit. Organizim eventësh argetuese, artistiko-kulturorë, etj. Në fushën e agjentimit, dizajnit, brandimit, paketimit, publicitetit dhe

prodhimit të materialeve publicitare, krijimit dhe publikimit të tyre në cdo lloj material apo forme tjetër reklamuese. Në fushen e ndertimit të të gjitha objektëve të banimit, turizmit, rrugëve, objektëve bujqësore, industriale, shendetësore etj. Sherbim pastrimi mirembajtje dhe menaxhim, projektim interier, eksterier, realizim fasada, projektim dhe zbatim i tyre. Zhvillimin, prodhimin dhe tregtimin e produktëve dhe shërbimeve inovative me vlerë të lartë teknologjike. Menaxhimi i drejtpërdrejtë dhe krijimi i faqeve të internetit dhe b2b dhe b2c platformave të tregtisë elektronike, në Shqipëri dhe jashtë vendit, për çdo kategori produkti ose nënprodukti; Menaxhimi i dyqanëve fizike me pakicë dhe me shumicë të çdo produkti të tregtuar nëpërmjet internetit;

Zhvillimi, prodhimi dhe tregtimi i platformave, aplikacioneve, aplikacioneve celulare ose mjeteve të tjera të web-it në përgjithësi; Zhvillimin, prodhimin dhe tregtimin e shërbimeve IT dhe telematike; marketingut në intërnët; Zhvillimi dhe zbatimi i softwar-it, si dhe instalimi dhe zbatimi i terminaleve të pagesave elektronike dhe shërbimet e lidhura me këtë të fundit. Ndërtimi i rrjeteve wireless dhe intranet etj; Konsultime të ndryshme, Tregtia me shumicë dhe pakicë, eksporti i importit, impiante që prodhojnë energji nga burime të ripërtëritshme dhe jo të ripërtëritshme, të tilla si panëlet diellore dhe mini termocentralet; makinat e riciklimit; materiale elektrike, pjesët e makinave, produktët e tekstilit, mobilje dhe mobilje zyre, mallra sportive, produktë ushqimore. Përfaqësimi i kompanive dhe pjesëmarrja në tënderë në institucionët publike dhe /ose privatë në Shqipëri dhe jashtë vendit, blerja e patëntave dhe licencave në Shqipëri dhe jashtë saj.

Hulumtimi dhe analiza e tregut, zhvillimi i planëve industriale, kërkimi i partnerëve strategjikë, organizimi i takimeve, konferencave dhe gjithçka e nevojshme për të zhvilluar këto shërbime konsulence. Shitja, mbajtja, administrimi i letrave me vlerë publike dhe privatë, kombëtare dhe të huaja, ekzekutimin e shërbimeve në emër dhe në favor të personave fizikë, kompanive, konzorciumeve, shoqatave ose organëve të tjera, publike ose privatë, kombëtare ose të huaja dhe individëve nëpërmjet përpunimit të të dhënave. Zhvillimin e procesit për rekrutimin e stafit dhe organizimin e informacionit, kurseve të arsimit dhe trajnimit. Zhvillimin e

aktivitetët e marketingut strategjik dhe operacional dhe hulumtimi i tregut, hulumtim dhe zhvillim Tregtim të produktëve mjekesore.

## KREU II KAPITALI I SHOQËRISË TRANSFERIMI I KUOTAVE FINANCIMI

### NËNI 5 KAPITALI I SHOQËRISË

- 5.1 Kapitali i Shoqërisë është 1,000,000 ( njëmilion ) lekë, i përbërë nga 1 (një) kuotë me vlerën 1,000,000 (njëmilion ) Lekë. Ortaku **Z. Anthony Jean-Claude Jelinek** zotëron 1 kuotë që përfaqësohet 100% të kapitalit me vlere 1,000,000 ( njëmilion ) lekë i cili është paguar tërësisht në para nga Ortaku **Anthony Jean-Claude Jelinek** , shtetas Belg, lindur në Sint-Agatha-Berchem, më 01 maj 1993, mbajtës i Pasaportës Nr. ES123753 banues në Belgjikë, përsone madhor e me zotësi të plotë juridike e për të vepruar.

### NËNI 6 TRANSFERIMI I KUOTAVE TË KAPITALIT TËK TË TRETËT

- 6.1 Kuotat e shoqërisë mund t'u transferohen lirisht të tretëve vetëm me miratimin nga Asambleja e ortakeve, sipas dispozitave ligjore në fuqi.
- 6.2 Kontrata e kalimit të kuotës bëhet me shkrim, pranë një notëri dhe i njoftohet shoqërisë.
- 6.3 Transferimi i tyre, merr vlerë vetëm pas regjistrimit të kalimit të kuotave pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.

### NËNI 7 BARRËT MBI KUOTAT E KAPITALIT

- 7.1 Kuotat e kapitalit të Shoqërisë mund të rendohen lirisht me barrë siguroese apo të drejta të tjera reale.

## KREU III

## NDRYSHIMI I KAPITALIT

### NËNI 8

- 8.1 Zmadhimi i kapitalit themeltar me anën e kontributëve në natyrë apo zvogëlimi i tij bëhet me miratimin e Asamblese se Ortakeve mbi bazën e një projekti të paraqitur nga eksperti kontabël i autorizuar dhe me kërkesën e Asamblese se Ortakeve apo Administratorit të Shoqërisë.
- 8.2 Zvogëlimi i kapitalit themeltar, bëhet në bazë të dispozitave të Ligjit Nr. 9901 datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”.

### NËNI 9

## ZMADHIMI I KAPITALIT

- 9.1 Asambleja e Ortakeve, mund të vendosë që rritja e kapitalit të bëhet dhe me rezervat dhe fitimet e pashpërndara të shoqërisë, gjendje të cilat figurojnë deri në datën 31 dhjetor të vitit/vitëve financiar/financiare paraardhës/paraardhëse. Kjo gjë bëhet vetëm pasi Asambleja e Ortakeve, me vendim të ketë miratuar llogaritë vjetore të shoqërisë për vitin/vitët e mbyllur/mbyllura financiar/financiare paraardhës /paraardhëse.
- 9.2 Pas marrjes së një vendimi të tillë, Asambleja e Ortakeve cakton një ekspert kontabël të regjistruar për vlerësimin e zmadhimit të kapitalit themeltar me rezervat dhe fitimet e pashpërndara të shoqërisë, gjendje të datës 31 dhjetor të vitit paraardhës.
- 9.3 Pas prezantimit të aktit të vlerësimit nga eksperti kontabël i regjistruar, Asambleja e Ortakeve të Shoqërisë, me një vendim tjetër, përcakton mënyrën e rritjes së kapitalit themeltar të shoqërisë.
- 9.4 Pas marrjes së vendimit të dytë nga Asambleja e Ortakeve të Shoqërisë, e gjithë procedura e ndjekur në zbatim të këtij nëni do të depozitohet pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit sipas parashikimeve të Ligjit Nr. 9723 datë 03. 05. 2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”.

## KREU IV


## ORGANIZIMI I SHOQËRISË

## NËNI 10 STRUKTURAT DREJTUESE DHE VENDIMMARRËSE

- 10.1 Shoqëria tregtare NZ GROUP SHPK ka si struktura drejtuese dhe vendimmarrëse :
- Asambleja e Ortakeve të Shoqërisë si organi vendimmarrës për shoqërinë;
  - Administratorin

## NËNI 11 DETYRAT DHE PËRGJEGJËSITË E ORGANIT VENDIMMARRËS

- 11.1 Asambleja e Ortakeve të Shoqërisë, si organ vendimmarrës për shoqërinë, është përgjegjës për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:
- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
  - b) ndryshimet e statutit;
  - c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
  - ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
  - d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat “c” dhe “ç” të kësaj pike;
  - dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raportëve të ecurisë së veprimtarisë;
  - e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raportëve të ecurisë së veprimtarisë;
  - ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
  - f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
  - g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorit;
  - gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
  - h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
  - i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.



- 11.2** Asambleja e Ortakeve të Shoqërisë merr vendime për çështjet e përcaktuara në shkronjat “e” dhe “ë” të pikës “1” të këtij nëni, pas marrjes dhe shqyrtimit të dokumentëve përkatës.
- 11.3.** Të gjitha vendimet e marra nga Asambleja e Ortakeve të Shoqërisë do të regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen. Forma e regjistrit dhe mbajtja e vendimeve përcaktohen me vendim të Asamblese se Ortakeve të Shoqërisë. Asambleja e Ortakeve të Shoqërisë, me vendim, mund të ngarkojë dhe një person fizik për mirëmbajtjen e regjistrit të mbledhjeve.
- 11.4** Nga ana e Asamblese se Ortakeve të Shoqërisë merren të gjitha masat përkatëse për regjistrimin e vendimeve të saj pranë organëve përkatëse shtetërore dhe sidomos në veçanti, vendimet për:
- a) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raportëve të ecurisë së veprimtarisë;
  - b) shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
  - c) investime;
  - ç) vendimet për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
  - d) vendimet e marra në zbatim të nënit 9 të këtij statuti.
- 11.5** Vendimet e paregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme. Shoqëria nuk mund t’i kundrejtojë pavlefshmërinë të tretit, që ka fituar të drejta në mirëbesim, përveç rastit kur shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për pavlefshmërinë, apo në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishtë pasur dijeni për të.

## NËNI 12

### MBLEDHJA E ORGANIT VENDIMARRËS

- 12.1** Mbledhja e Asamblese se Ortakeve të Shoqërisë zhvillohet në rastët e përcaktuara nga Ligji Nr. 9901 datë 14. 04. 2008 i ndryshuar “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”., nga ligje të tjera ose nga dispozitat e statutit dhe sa herë që mbledhja është e nevojshme për të mbrojtur interesat e shoqërisë. Mbledhja e ortakut të vetëm thirret dhe zhvillohet të paktën një herë në vit.



- 12.2** Mbledhja e Asamblese se Ortakeve të Shoqerise thirret nga kryesisht nga Asambleja e Ortakeve të Shoqerise ,administratori apo dhe nga eksperti kontabël i autorizuar kur ka nevojë për diskutime për çështje ekonomike që lidhen me shoqërinë.
- 12.3** Mbledhja e Asamblese se Ortakeve të Shoqerise,thirret nëse, sipas bilancit vjetor apo raportëve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 (tre) muajve në vazhdim.
- 12.4** Mbledhja e Asamblese se Ortakeve të Shoqerise thirret nga personat e tjerë të parashikuar nga pika 12.2 e këtij nëni jo më vonë se 7 (shtatë) ditë përpara datës së parashikuar në mbledhjen e Asamblese se Ortakeve të Shoqerise. Mënyra e thirrjes së mbledhjes kryhet sipas përcaktimeve përkatëse të parashikuara Ligjin Nr. 9901 datë 14. 04. 2008 i ndryshuar“Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”.

## KREU V

### ASAMBLEJA E ORTAKEVE, FINANCIMET

#### NËNI 13

##### ASAMBLEJA E ORTAKEVE

- 13.1** Asambleja e Ortakut të vetëm të Shoqerise i Shoqërisë është Ortaku **Anthony Jean-Claude Jelinek** , shtetas Belg, lindur në Sint-Agatha-Berchem, më 01 maj 1993, mbajtës i Pasaportës Nr. ES123753 banues në Belgjikë, person madhor e me zotësi të plotë juridike e për të vepruar.

#### NËNI 14

##### VENDIMET E ASAMBLESE SE ORTAKEVE

- 14.1** Asambleja e Ortakeve të Shoqerise, në përputhje me legjislacionin shqiptar merr vendime në lidhje me: (i) ndryshimin e këtij Statuti, (ii) zmadhimin e zvogëlimin e kapitalit të Shoqërisë, (iii) kalimin e kuotave të Shoqërisë, (iv) emërimin dhe shkarkimin e Administratoreve si edhe emërimin e shkarkimin e ekspertit(ëve) kontabël të autorizuar, (v) miratimin e bilancit vjetor të Shoqërisë si edhe të çdo raporti tjetër financiar, (vi) shndërrimin, shpërndarjen dhe likuidimin e Shoqërisë, (vii) emërimin e likuidatorit(ëve) dhe çdo vendim tjetër që sipas ligjit i takon Ortakut të Vetëm.



8

- 14.2 Asambleja e Ortakeve të Shoqerise duhet të merren me shkrim dhe të regjistrohen në regjistrin e mbajtur pranë selisë së Shoqërisë.

**NËNI 15**  
**TË DREJTAT DHE DETYRAT E ASAMBLESE SE ORTAKEVE**

- 15.1 Të drejtat dhe detyrat e Asamblese se Ortakeve të Shoqerise janë:
- Të marrë pjesë në mbledhjet e Asamblese se Ortakeve të Shoqerise;
  - Të paraqesë pyetje me shkrim në lidhje me aktivitetin dhe administrimin e shoqërisë;
  - Të informohet mbi përmbajtjen e raportit të administrimit, inventarët e llogaritë vjetore, tëkstët e vendimeve të propozuara, si dhe raportin e ekspërtit kontabël;
  - Të përfitoje nga fitimi i shoqërisë;
  - Të kërkojë prishjen e shoqërisë në rrethana të caktuara;

**NËNI 16**  
**FINANCIMI I SHOQËRISË**

- 16.1 Organi i Administrimit të Shoqërisë, në përputhje me dispozitat në fuqi, përveç rastëve të zmadhimit të kapitalit, ka të drejtë të kërkojë nga ortakët e shoqërisë fondet e nevojshme për arritjen e objektivave të shoqërisë.
- 16.2 Financimet e mëtëjshme të ortakeve në shoqëri do të jenë me shpërblim (intëresa) apo pa shpërblim, në varësi të titullit nëpërmjet të cilit do të lëvrohen këto fonde.

**KREU VI**  
**ADMINISTRIMI I SHOQËRISË**

**NËNI 17**  
**ADMINISTRIMI I SHOQËRISË**

- 17.1 Shoqëria administrohet nga 1 (një) Administrator i cili emërohet nga Asambleja e Ortakeve të Shoqerise për një periudhë 5 (pesë) vjeçare, me të drejtë rizgjedhje. Administratori i parë i Shoqërisë emërohet:
- **Anthony Jean-Claude Jelinek** shtëtas Belg, lindur në Sint-Agatha-Berchem, më 01 maj 1993, mbajtës i Pasaportës Nr. ES123753.




- 17.2** Në zbatim të këtij nëni, administratori i vetëm përfaqëson Shoqërinë kundrejt palëve të treta, përfshirë autoritetët publike dhe privatë, vendase ose të huaja, bankat, autoritetit tatimore dhe gjyqësore. Administratori është përgjegjës për veprimet e kryera në administrimin e Shoqërisë sipas këtij akt themelimi dhe statuti e legjislacionit shqiptar.
- 17.3** Administratori mund të ndërmarrë apo kërkojë kryerjen e të gjitha aktëve që konsideron të nëvojshme për arritjen e objektit të Shoqërisë, përveç atyre që ligji apo statuti i rezervon Ortakut të Vetëm apo organëve të tjera të Shoqërisë.

## NËNI 18

### TË DREJTAT DHE DETYRAT E ADMINISTRATORIT

- 18.1** Administratori ka të drejtë dhe detyrohet të:
- a) kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
  - b) përfaqësojë shoqërinë tregtare;
  - c) kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumentëve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
  - ç) përgatisë dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqet këto dokumentë përpara Asamblese se Ortakeve të Shoqërisë për miratim;
  - d) krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
  - dh) kryejë regjistrimet dhe dërgojë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në Ligjin Nr. 9723 datë 03. 05. 2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”;
  - e) raportojë përpara Asamblese se Ortakeve të Shoqërisë në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
  - ë) përfaqësojë shoqërinë në marrëdhënie me të tretët;
  - f) kryejë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.

## NËNI 19



**PËRGJEGJËSIA E ADMINISTRATORIT**

- 19.1 Administratori është përgjegjës individualisht sipas rastit ndaj vetë shoqërisë ose ndaj të tretëve për shkelje të ligjeve, për shkelje të Statutit apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

**NËNI 20**

**SHPËRBLIMI I ADMINISTRATORIT**

- 20.1 Asambleja e Ortakeve të Shoqërisë përcakton shpërblimin e Administratorit të shoqërisë.

**KREU VII**

**KONTROLI I KONTABËL I SHOQËRISË  
VITI FINANCIAR DHE BILANCI**

**NËNI 21**

**KONTROLI KONTABËL**

- 21.1 Kontrolli i jashtëm kontabël i Shoqërisë kryhet nga Ekspertë Kontabël të Regjistruar, në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi. Asambleja e Ortakeve të Shoqërisë do të emërojë një apo më shumë ekspertë kontabël në ato rastë kur emërimi i tyre konsiderohet i nevojshëm ose kërkohet në bazë të ligjit.
- 21.2 Për kompetencat, detyrimet, përgjegjësitë, zëvendësueshmërinë, tërheqjen, shkarkimin dhe shpërblimi i tij zbatohet legjislacioni shqiptar në fuqi.

**NËNI 22**

**VITI FINANCIAR**

- 22.1 Viti Financiar i Shoqërisë fillon më 1 Janar dhe mbaron më 31 Dhjetor të çdo viti.

**NËNI 23**

**BILANCI DHE REZERVAT**

- 23.1 Me mbylljen e secilit vit financiar, Administratori merr masat e nevojshme për hartimin e bilancit të aktivitetit për vitin financiar të mbyllur, në mënyrë



që Asambleja e Ortakeve të Shoqerise të vendosë mbi miratimin apo ndryshimet e mundshme të tij brenda afatëve të përcaktuara nga ligji.

- 23.2** Asambleja e Ortakeve të Shoqerise vendos mbi ndarjen e dividendëve që rezultojnë si fitime sipas bilancit të miratuar rregullisht, pasi nga këto shuma të jenë zbritur humbjet e mundshme të vitëve të mëparshme.
- 23.3** Asambleja e Ortakeve të Shoqerise në çdo moment mund të vendosë krijimin e rezervave, si edhe masën e tyre.

## **NËNI 24 PUNËSIMI NË SHOQËRI**

- 24.1** Të gjithë personat që do të punësohen pranë kësaj shoqërie, punësimi i tyre do të bëhet mbi bazën e kontratës individuale apo kolektive, sipas rastit, në të cilën do të përcaktohen të drejtat dhe detyrimet ligjore të secilës palë si dhe paga mujore në përputhje me legjislacionin shqiptar në këtë fushë.

## **KREU VIII PRISHJA DHE NJOFTIMET**

### **NËNI 25 PRISHJA DHE LIKUIDIMI I SHOQËRISË**

- 25.1** Shoqëria mund të priset në çdo kohë dhe për çfarëdo lloj shkak, si në rast falimentimi, privim të të drejtave për të ushtruar aktivitet tregtar, forca madhore dhe faktorë të tjerë që nuk varen nga Asambleja e Ortakeve të Shoqerise.
- 25.2** Shoqëria hyn në fazën e likuidimit qysh në momentin e prishjes së saj. Për kryerjen e këtij procesi, Asambleja e Ortakeve të Shoqerise emëron një ose disa likuidatorë, të cilët i paraqesin asaj raportin mbi gjendjen e aktivitet dhe pasivit të Shoqërisë, mbi ndjekjen e operacionëve të likuidimit dhe afatin e nevojshëm të përfundimit të tyre. Shoqëria priset në këto rastë:



12

- Kur nuk mund të përmbushet objekti për të cilin është krijuar shoqëria;
- Me vullnëtin e ortakëve;
- Me vendim të Gjykatës
- Shkaqe të tjera të parashikuara në ligj

## NËNI 26

### PROCEDURAT QË NDIQEN

- 26.1** Likuidimi i shoqërisë tregtare NZ GROUP SHPK vendoset nga Asambleja e Ortakeve të Shoqërisë kur prishet shoqëria.
- 26.2** Likuidimi i shoqërisë do të bëhet duke zgjedhur procedurën e zakonshme të parashikuar në Ligjin Nr. 9901 datë 14. 04. 2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”.
- 26.3** Në qoftë se Asambleja e Ortakeve të Shoqërisë, për mbylljen e parashikuar, nuk mund të marrë vendim ose ai nuk pranon të miratojë llogaritë e likuiduesit vendimi merret nga Gjykata me kërkesën e likuiduesit ose çdo personi të interesuar.
- 26.4** Nëse nuk është proceduar si më sipër Gjykata me miratimin e Asambleja e Ortakeve të Shoqërisë zbaton dispozitat ligjore dhe në se miratimi nuk është dhënë deri në seancën e parë gjyqësore ky miratim prezumohet i mirëqenë.
- 26.5** Në fund të procesit të likuidimit thirret Asambleja e Ortakeve të Shoqërisë për të vendosur në lidhje me bilancin financiar përfundimtar.

## NËNI 27

### NJOFTIMET

- 27.1** Të gjitha njoftimet, kërkesat ose komunikimet e tjera që u jepen personave ose që bëjnë personat sipas Statutit do të kryhen me shkrim ose përmes



13

komunikimit elektronik (nëse ka) dhe do të konsiderohen të kryera në mënyrë të rregullt kur u dërgohen në adresat e deklaruara prej tyre pranë Administratorit të Shoqërisë.

- 27.2** Njoftimet zyrtare të komunikimeve me anë të mjetëve elektronike vërtëtohen sipas Legjislacionit për nënshkrimin elektronik dhe dërgohen në adresat elektronike të deklaruara prej tyre.
- 27.3** Në rastin kur një kuotë zotërohet nga më shumë se një person, të gjitha njoftimet do ti drejtohen përfaqësuesit të bashkëzotëruesve të kuotës.

## **KREU IX BASHKIMI DHE NDARJA E SHOQËRISË NËNI 28**

- 28.1** Shoqëria NZ GROUPS HPK me anë të bashkimit mund t'i kalojë trashëgiminë e saj një shoqërie ekzistuese ose një shoqërie të re që ato themelojnë që ushtron të njëjtin aktivitet.
- 28.2** Gjithashtu shoqëria NZ GROUP SHPK me anë të ndarjes mund t'i kalojë trashëgiminë e saj disa shoqërive të tjera ekzistuese ose disa shoqërive të reja.
- 28.3** Në rast se operacioni përfshin krijimin e shoqërive të reja secila prej tyre themelohet sipas rregullave që i për NZ GROUP-in shoqërisë që do të krijohet.
- 28.4** Transferimi i plotë i aktivitetit të shoqërisë apo kontributi në aktiv të një shoqërie tjetër, veçanërisht me anë të procesit të bashkimit duhet të autorizohet nga Asambleja e Ortakeve të Shoqërisë.

## **KREU X DISPOZITA PËRFUNDIMTARE NËNI 29 LIGJI I ZBATUESHËM**



14

- 29.1 Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë dhe Statut dhe me ligjin shqiptar. Për sa nuk është parashikuar në këtë akt, do të zbatohen dispozitat e legjislacionit shqiptar në fushën e shoqërive tregtare.

**NËNI 30**

- 30.1 Ky Statut përpilohet në 4 (katër) kopje origjinale secili me të njëjtën vlerë ligjore. Njëri prej tyre ruhet në dokumentacionin bazë të shoqërisë

**Asambleja e Ortakut të Shoqërisë  
Të  
SHOQËRISË NZ GROUP SHPK**

**Anthony Jean-Claude Jelinek**

ANTHONY JELINEK

Datë 26.10.2022

